

Nexhdet
Deveja

BU

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-1

845

RI
MET

viersha

8JH-1
845

NEXHDET DEVEJA

BURIMET

vjersha



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor: **Vehbi Skënderi**

Kopertina nga: **Svjetllana Strazimiri**



Tirazhi 1.500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204 - 72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973

ÇAST PUSHIMI

Në zbor

Jam shtrirë mbi barin e njomë
e dëgjoj zërat e natyrës.

Qetësi.
Të gjithë pushojnë.

Pushkët i kemi kulmuar tok.
Mbi pushkët tona këndon një zog.

MIMOZA

E heshtur qëndron ti, atje ku të kanë mbjellë,
në një trotuar, në një oborr shkolle a në një uzinë,
në një lulishtë, a në një shesh të ri.
Ke hapur krahët dhe ngjyrën e artë ia ke rrëmbyer
natyrës,
në nuancat më të bukura, në shkëlqimet më të
ndritura.
E ke mbledhur atë bukuri në kokrriza botësh të
vogla
dhe e ke veshur me aromën e ëmbël freskuese,
që e përhap rreth vetes valë-valë.

Vallë, e di ti,
se ke kaq bukuri?

I ndjen ti vështrimet e vajzës së gëzuar?
Prekjet e saj të lehta kur këput me kujdes një biskit?

Ia dëgjon ti rrahjet e zemrës në ato çaste,
ëmbëlsinë e syve të saj, dashurinë e syve të saj?

O, mos i folë vajzës së dashuruar.
Dashuria kërkon bukurinë, gëzimin, lirinë...
Dashuria kërkon dashurinë.
Lere Mimosën t'i mbushë me mimoza ato duar.

Ti ke aq shumë lule në duart e tua...
aq bukuri... aq ëmbëlsi...
Falmë mimosë një lule edhe mua,
dhe merre këtë poezi.

VJESHTE

Dielli zbret nga kulmi.
Era vrapin e shpejton.
Jashtë e brenda ulet barometri.
Pema gjethet i lëshon. . .

Shiu nis e s'di të pushojë.
Majëmalesh dimri zgjat kotën të shikojë.

Z G J I M

Nata ende fle mbi qytet.
Mjegulla rrugët i ka mbuluar.
Një dritare çel syrin në apartament.
Nëpër xhama drita shpon natën e përtuar.

Një motor buçet përtej me uturimë.
Maqina nëpër asfaltin e lagur rrëshqet.
Dy dritare të tjera hedhin dritë mbi rrugë, atje në
kthinë.
Qyteti nis të zgjohet.

Prozhektorët e maqinave çajnë errësirën nëpër
rrugë.
Apartamentet çelin sytë e ndritshëm një nga një.
Nata përton të ngrihet. Po dritat e kanë shpuar
shumë...
Qyteti mbushet me jetë.

KËNGA PARTIZANE

Një këngë dëgjohet jashtë në rrugë,
dal në dritare edhe shoh:
djem e vajza, në rresht me pushkë.
Kënga e tyre zemrën ma ngroh.

Ç'më shtyn kjo këngë në vitet e shkuara,
rininë e zjarrtë më kujton.
O, sa herë këtë këngë e kam kënduar
me shokët, në luftë, në pozicion.

O këngë e luftës partizane,
këngë e zemrave barot,
zjarr u ndeze atëhere në male,
zjarr i ndez zemrat edhe sot.

SHTETRRETHIM

1

Trak — trak... Trak — trak...

Katër çizme, mbërthyer me thumba, trokasin mbi
kalldrëm.

Nën dritat e zbehta të rrugës, dy hije zvarriten si
gjarpëri.

Dridhen, zgjaten, ngjiten, mblidhen,
mbi mure, mbi dyer, lidhen si lak.

Natë e rëndë. Qiell i nxirë. Heshtje e vrarë.

Qyteti duket pa jetë — qytet me mure të shkreta —
(si pas një rrëmeti mbytës kaluar).

Pa një rrahje,

pa një ngjitje,

veç mbi kalldrëm të vdekjes trokitje:

Trak — trak... Trak — trak...

Zot të vërtetë
(si vdekja mbi jetë)
ndjejnë se janë ato koka nën helmetë.

2

Por... (o ironi!)
pas mureve, nën çati,
brenda dritareve me batanie zënë,
merr frymë i gjallë, plot forca, qyteti,
gati për lindje, si grua shtatzënë.

Ja, gjaku i tij në rremba lëvrin.
Një, dy, tre... kalojnë shpejt një prak.
Rrëzë mureve shkasin, si ketrat në pyll
e kudo lenë pas, si gjurmë,
nga një trakt,

nga një buçitje,
nga një flakë...

nga një yll.

MALET E SHQIPËRISË

Male. . .

O malet e Shqipërise!

Male të larta. . .

Kështjella që ngrini kokën përmbi re.

Male, ku shqiponjat kanë fole.

Ç'buçitje në shekuj, në jehonë keni kthyer.

Sa dashuri për bijtë tuaj,

sa urrejtje për të huaj,

në gjitë e ndezur keni ushqyer!

Shikoj malet krenare:

Shqipërinë me hije mbulojnë.

Atdheut,

mburojë i qëndrojnë.

MINATORI

Atje ku punon ti, është thellë, shumë thellë.
Rrugë të nëndheshme të çojnë.
Taban e tavan i tokës — shkëmb edhe gurë,
veshur në armaturë.
Ajri është i rëndë
edhe qiell nuk ka.

Atje ku punon ti, është shumë thellë.
Dhe drita e diellit s'arrin të hyjë.
Dhe era - erën s'arrin ta shtyjë.
Po ti ia ke kaluar diellit.
Më i lehtë se era hyn e del.
E qiell e hapësirë ke zemrën në kraharor.
Dhe hov i punës sate
buis në trupin e Atdheut,
si buis natyra në pranverë,
shok minator!

VALLZIMI I MUSKUJVE

Tinguj metalikë... Këngë metalike...
Sinfoni e madhe e punës.
Më e madhja nga të mëdhatë sinfoni.
Përkulen trupat. Mbërthejnë duart. Tendosen
nervat
e muskujt vihen në lëvizje.
Mblidhen, hapen, zgjaten, shtrëngojnë,
me vegla e mbi vegla, mbi pistën e maqinave.
O sa bukur duken! Sa bukur vallzojnë!
S'ka si vallzimi i muskujve nën tingujt metalikë.
Të isha piktor, o më mirë skulptor,
vallzimin e muskujve të gjallë do ta kisha dhënë.

Në trupin e botës —
shëndeti, forca, lëvizja —
muskuli punëtor.

ALIBIA E SHQIPONJËS

Muzgu i mbrëmjes mbi male shtriu krahët.
Shqiponja e lodhur ra në fole.

Natë.

Po zog' i lartësive nuk po fle.
Iu bë atij atë mbrëmje
sikur nga qielli
ranë mbi tokë një grumbull yjesh.

Tjetër natë.

E përsëri pagjumësi,
kurrestje e çudi.

Iu bë atij
sikur prapë nga qielli
ranë mbi tokë një grumbull tjetër yjesh.

Ditën ka qartësi:

toka poshtë, qielli lart.

Po natën?...

(mos është e sëmurë e ka alibi?)

Sa çudi!...

Ku është qielli?

Ku është toka?

Ku janë malet?

Mos kanë lëvizur ata?

Ditën shqiponja i shikon në vend.

Po natën?!...

Ç'janë ata grumbuj yjesh të rënë nga qielli?!

(Mos ditën lodhet në fluturim e natën mendët i
merren?..)

Yje në qiell,

yje në male!

Dritë lart,

dritë poshtë!

Malet e lartë, ku në shekuj ky shpend i paepur
flinte nën yje,

tani ndritin nga grumbuj yjesh që flakërijnë edhe
rreth saj natë për natë!

O shqiponjë krenare.

O zog trim i shqiptarëve.

Yjet poshtë nuk kanë rënë.

Shqipëria është ngritur lart, ja afroi yjeve Partia
mëmë.

Dhe malet nga vendi nuk kanë lëvizur:
mbi ta ka rënë drita e Partisë dhe i ka ndritur.

Kjo dritë: në fushë, poshtë.

Kjo dritë: në male, lart.

Kjo dritë: mbi gjithë Shqipërinë.

Drejt komunizmit dyert na i hap.

PARTIA

Them: qiell, hapësirë, dritë.

Them: diell, ajër, ujë.

Them: sytë, mendja, zemra.

Kam thënë: Partia.



12065

Me ne
e ulën kokën sot
edhe lule, edhe zogj.
Kurora të freskëta
varret e të rënëve mbulojnë.

Pesë Maj!
Shtatë germa në dy fjalë.
Shtatë germa në dy fjalë edhe: Gjak — Liri!
Njëzetetë mijë dëshmorë
iu bënë Shqipërisë në kokë kurorë.

5 maj!
Nëpër jetë do të skuqë kjo datë.
Këtë ditë populli jua dha juve,
juve që buzagaz për popullin jetën dhatë.

F A R I

*«Shqipëria popullore heroike është bërë
një fener i madh ndriçues i socializmit
në Europë.»*

Mao Ce Dun

Adriatik dhe Jon!
Gjithë bota dëgjon sot buçitjen e valëve tuaja,
këngën tonë në Revolucion.

Atje ku er' e lirë trazon ujërat që bashkohen,
e valët kreshtëbardha shtyn në brigjet lindorë,
një fener i kuq — yll në hapësirë —
ndrit si far.

1960

U ngrit grushti shqiptar lart,
mbi tavolinë ra:
— Mjaft folët përçart
ju revizionistë.

E sipari u hap...
Duartrokite bota!

VIZATIM

Një natë, tre vogëlushë në garë ishin vënë,
kush do të vizatonte figurën më të bukur.
Përkulur rreth tavolinës vizatonin të heshtur:
hidrocentralin, trenin, kombajnën në lëmë.

Me ta femininë time krahasova.
Kujtova si më digjnin sytë nga tymi i llambës,
kur hidrocentralin, trenin, kombajnën...
s'i kisha parë, s'i kisha dëgjuar.

Trenit në vizatim atë çast i hypa,
Atdheut rreth e rrotull i rashë me gëzim.
Hidrocentralet, kombajnat... sodita.
Sa i bukur! Sa i fortë vendi im!

QËNDROJ NË TY ATDHE

Shqipëri, atdhe i dashur!
Qëndroj në ty, si e dymiliona pjesë e jotja.
Qelizë e gjallë në trupin tënd.
Pikë gjaku në venat e tua.
Rrahje e përditshme e zemrës sate.
Një dredhëz në trurin e madh mendimtar.
Një hap në marshimin e kuq krenar.

FOTOGRAFIA NË STENDËN E TË DALLUARVE

Shkova në një uzinë disa ditë me radhë.
Në oborr, karshi hyrjes,
dy sy të një portreti vendosur në stendën e të
dalluarve,
më shikonin çdo ditë ballë për ballë.

Se ç'më trazonte ai vështrim, se ç'më ngjallte në
shpirt,
s'e kuptoja mirë,
veç i kërkoja ata dy sy, atje në stendë, çdo ditë.

Dhe kur futesha në ndonjë repart,
i kërkoja t'i ndeshja të gjallë ata sy.
Mendoja:
ç'hove në shpirt, e ç'forcë në duar,

do të ketë ajo që më shikon aq ngultas,
me ata sy të bukur nga portreti i zmadhuar.

Dhe një ditë iu luta inxhinierit teknolog,
të më çonte te njeriu i portretit që s'e gjeja dot.

Dhe ai më shpuri.

Para meje:

një sallë e madhe... plot maqineri.

Pranë tyre.

dhjetra vajza e djem të rinj.

Kërkova në to ata sy.

Në fund të sallës, inxhinieri më tha:

— Ja ku është, ajo vajza atje me shami blu.

Shikoj:

Një frezë e madhe.

Punëtorja — si flutur pranë saj.

Ajo maqinë gjigante e tregonte më të vogël vajzën
punëtore.

S'ishte ajo me trup të fortë.

me duar të fuqishme, si e mendoja.
Po kishte në ballë dy sy të mëdhenj, që pasqy-
ronin një ndërgjegje të lartë.

Dhe m'u rrit ajo, me atë shpirt klase, në sytë
e mi,
si një shqiponjë e vërtetë.
Në grafikun e planit të saj:
shifra 110.

REPUBLIKA

Dy milion ushtarë — bashkuar në një.
Jo kolonë zinxhir,
as rresht radhështrenguar.

Po grusht bashkuar
Katër milion grushte — në një.

ZEMRA E USHTARIT

Kush e preku dhe s'ndjeu rrahje dashurie?

Kush e desh e s'hyri vetë brenda në të?

Zemër e ngrohtë — vatër besnikërie.

Zemër e fortë — falur Atdheut në paqe e në luftë.

DALLËNDYSHE, O ZOGTH I SHPEJTË

Sa vjet rron ti?
Sa pranvera ke lajmëruar në vendin tim?
O zogth i shpejtë!
Bukuri krahëlehtë!
U nise ti dhe këtë vjeshtë të shkosh,
në vendet e ngrohta, tej detrave, të mërgosh.

Shko dallëndyshe.
Ti do veç diell e ngrohtësi.
Dhe i kërkon këto në natyrë, larg, larg.
Sikur të hapej gjoksi i njerëzve,
në zemrën e popullit tim do të kishe dimëruar ti,
pa u lodhur në shtegëtimet e gjata... varg... varg...

KALAJA

Mure të larta me gurë
Mure të gjëra me gurë.

Bedena në muret e larta,
Frengji në muret e gjëra.

Mure shtat-hedhura,
si të zotët.

Mure të forta
që mbronin zemra të forta.

Çdo gur...

një fletë historie..

GJIGANTI I HEKURT

Në kombinatin e metaleve të zeza,

Kombinati — hekur i tëri:
hekur maqineritë,
hekur lënda e parë,
hekur dhe vetë njerëzit.

Mora në duar një copë hekur:

Metal i zi — punuar prej duarve të bardha.
Metal i fortë — ngjeshur prej vullneteve çelik.

NATËN E MIRË

T'u lodhën sytë mbërthyer mbi kartë.
U lodh edhe era duke fryrë jashtë...
T'u lodh dora gjer vonë duke shkruar.
U lodh edhe deti duke buçitur me valë
shkumëzuar...

Mjaft punove sonte ti.
Pusho tani, shplodhu, shko bjerë fli.
Natën e mirë!

Po ti je larg, larg,
nuk më dëgjon.
Në prakun e dritares,
atje në breg të detit, ku ke shkuar për pushime,
gjer natën vonë
shkruan... shkruan...
E vargjet derdhen,

PEISAZH DETI NË DIMËR

Deti tërbohet në furtunë.
Qielli ka hedhur krahëve pelerinën gri të reve
ngarkuar me shi.
Atje ku retë puthin valët,
shkrep një vetëtimë.

LAMTUMIRË SHKOLLË

I lamë sot përgjithmonë bangat e dashura.
Lamtumirë shkollë!
Në zemër ruajmë për ty kujtimet më të bukura...
Kujtime rinie.

Na mbajte e rrite ti, si zogj, plot dashuri.
Sa e ëmbël jeta na qe,
sa e bukur, në gjirin tënd.
Si një farkëtar i mirë, na kalite në mësim, në
punë e në stërvitje ti.

Shkollë e dashur! Pranverë!
Sa herë mendja në ty ka për t'm'u kthyer.
Sa herë në kujtime do të futem përsëri nëpër
tënden derë.

Vitet e tua,
o, kush i ka harruar?
Për vitet e tua
S'ka lamtumirë!

NË FUSHË

Parcela me grurë — si det i blertë.

Era pranverore përkëdhel bisqet e njoma,
duke ngritur mbi fushë valë pambarim.

Mëngjuz.

Dielli ngre kokën mbi mal.

Po vajzat kooperativiste
më parë se dielli në fushë kanë dalë.

GËZIME PUNE

Sonte, në turnin e natës,
ajo shkoi në punë me një gëzim të veçantë në
zemër.

Përse vallë?
Nesër hapet Kuvendi i madh i Partisë.
Ajo mbyll sonte
vitin e parë
të pesëvjeçarit të ri.

Në rrjedhën e kohës
kalendari shënon për nesër: 1 Nëntor 1971.
Në kartelën e punës së saj
normistja e mbyll sonte këtë vit.
Nesër, me Kongresin e Partisë,
ajo hap vitin e ri.

TUNGJATJETA XHA MURAT

Tungjatjeta xha Murat!
Të përshëndes nga apartamenti i ri.

Me ty,
përshëndes dhe të gjithë shokët e tu:
muratorë e karpentierë,
hidraulikë, elektrikistë, bojaxhi,
arkitektë e inxhinierë...
dhe punonjësit e tjerë që ju kanë ndihmuar me
punë vullnetare.
Përshëndes të gjithë ndërtuesit e godinave të
bukura,
që rrisin e zbukurojnë qytetin tim.

Tungjatjeta
të gjithë juve që keni vënë dorë në apartamentin
tim.

Edhe ju që punoni në ndërtesën për karshi.
Dhe ju të tjerë ca më tej.
Të gjithëve,
kudo që jeni,
kudo që ndërtoni
shtëpi të bukura,
shtëpi komode,
shtëpi të lira për popullin.
Tungjatjeta!

Në shtëpinë e re e ndjej veten shumë mirë.
Jam i gëzuar.
Edhe gruaja është e gëzuar.
Edhe fëmijët.
Ju lumshin duart.

Xha Murat!
Kur të shoh atje lart në katin e pestë,
sot këtu,
nesër atje...
zemra më gëzohet
dhe pa më ndjerë ti, të përshëndes!
Them me vete:
xha Murati me shokë,
shokët e xha Muratit,
po i japin popullit

edhe një blok tjetër me pallate bukuri.
Dhjetra familje të tjera,
qindra njerëz të tjerë,
dalin nga shekulli i shkuar,
hyjnë në shekullin e ri.

Tungjatjeta xha Murat!
Tungjatjeta shokë të xha Muratit!

Me shpirtin tuaj të madh të klasës,
me veglat tuaja të punës,
ngrejeni jetën tonë,
barteni sa më lart.
Ta lemë pas botën e vjetër kapitaliste,
që ka ngritur lart flamurin e qirave të larta
e krizën e madhe për shtëpi,
ku njerëzit ngrysen
në getot e varfëra,
nën urat e hapura,
në katër rrugët, pa cati.

Tungjatjeta!

BISEDË ME NDËRGJEGJEN

Shpesh, natën kur bie të fle,
e trupin e lodhur nga puna dhe endjet e ditës
shtratit të ngrohtë ia jap,
një zë më flet nga thellësi e kraharorit:

— Hapi yt
a iu përgjigj sot
hapi të Revolucionit?

Dhe mendoj. . .
Zemrën e kam të ngrohtë,
po nesër do të bëj edhe më shumë.

Bisedoj kështu me ndërgjegjen,
gjersa, dalëngadalë. . . kapitem në gjumë.

DRITARE NË AKSION

Sërish qyteza ra në heshtje.
Pushoi kënga.

Pushuan të qeshurat e thirrjet rinore.

Nuk dridhen më telat e kitarës nën gishtat e
skuqur nga kallot.

Qyteza fle.

Flenë aksionistët në barakat e bardha.

Pushojnë pranë tyre dhe veglat e punës.

Dhe gjethet s'i përkund më puhiz'e mbrëmjes.

Veç dritat kanë tani radhën e punës,

dhe roja — syri i qytezës.

Rrjedh lumi aty poshtë pa pushuar,
dhe bulkthi këndon.

Përse sonte kaq vonë, ti ende rri zgjuar?

Nga dritarja e hapur çfarë po shikon?

Fle qyteza.

Ç'udhë kanë marrë sonte mendimet e tua?

Ja sheshi përpara, ku ti hodhe valle.

Nata i ruan me freski gjurmët mbi dhe.

Ja dhe rrapit ku u pështete të shplodheshe.

Ai rrap, sa çaste gëzimi të ëmbla ruan!

Ç'shikon ti sonte nga dritarja, natën vonë?

Ç'gjurmojnë sytë me atë vështrim aq të malluar?

O, ata sy, aq të hapur, aq të mëdhenj, shoqet e
shokët kurrë s't'i kanë parë.

Mos do ti sonte, gjithë qytezën ta mbledhësh si
lulet në duar?

Qyteza fle.

Ti nesër shkon. . .

O, këto ditë mos kishin kurrë të mbaruar!

PIKA E UJIT

Kujt goja s'iu tha nga etja,
kujt buzët s'iu rreshkën si eshkë.
kujt zhegu s'ia dogji zverkun
dhe e përpjeta s'ia mori frymën,
kujt s'iu shter paguri në marshime,
kujt gjaku s'iu mpiks në plagën e hapur,
kush s'i ra malit rrotull për të gjetur një burim,
kush s'u gjend në mes të detit, pa ujë,
kush s'lëpiu vesën mbi bar, në agim,
kush nuk përtypi në gojë fletë,
kush nuk e pa ujin në ëndërr
ai s'e di çdo të thotë: — një pikë ujë.
Ai s'e di çdo të thotë ushtar.

PAK DRITË!

...Pak dritë, o shok, o vllaf

Migjeni

Pak dritë! — kërkoi Migjeni.

Kalonte mbi Drin e thërriste:
Pak dritë!...

Se nata po ia verbonte sytë.

Po vala goditte mbi valë
e forca mbytej në det.

Dhe u shua ai,
nën flakën e pishës, si qiri.

Tymi ia dogji sytë.
Tymi ia nxu mushkëritë.

Për... pak dritë!

.....

O... pak dritë!

Se një natë s'kishte as pishë...

Po vala e Drinit goditte mbi valë
e forca mbytej në det.

USHTARI NË KUFİ

Kur festojmë natën e vitit të ri
në dhomat e salonet tona të ngrohta,
e qeshim, këndojmë, vallëzojmë e ngremë
dolli,
e dimë.
gëzimin tonë ka mbuluar me kapotë
ushtari që bën roje në kufi.

PRANVERA TROKET

Dielli e ngrohu rrezen. Dita më shpejt agon.
Dimri mbliidhet. Dritaret hapen. Strehët kullojnë.
Dëgjon si troket pranvera jashtë?
Pik. . . pik. . .

Toka heq nga trupi mbulesën e trashë të bardhë dhe
e shtrydh.
Ujërat e ftohta mbledh në përrenj e lumenj e i hedh
në det.

Avulli i ngrohtë çmpin gjymt; rët e bimëve
e bari del jashtë e luan me rrezet e diellit,
si lozin qingjat, si kërcejnë kecat përmbi të.
Syth' i njomë nxjerr kokën nga dega e pemës
mëmë,
«Mirëmëngjesh, o këngë e lirë!» zogun përshëndet.
Një grusht dëborë ka mbetur ende anës trungut,
përmbi rrënjë,
gjurmë e fundit e dimrit në atë breg.

Në dritare, ti,
dëgjon pranverën si troket?
Pik... pik...

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Çast pushimi	3
Mimoza	4
Vjeshtë	6
Zgjim	7
Kënga partizane	8
Shtetrrrethim	9
Malet e Shqipërisë	11
Lavdi punës së minatorit	12
Vallzimi i muskujve	13
Alibia e Shqiponjës	14
Partia	17
5 Maj	18
Fari	19
1960.	20
Vizatim	21
Qëndrojnë në ty atdhe	22
Fotografia në stendën e të dalluarve	23
Republika.	26
Zemra e ushtarit	27
Dallëndyshe, o zogth' i shpejtë	28
Kalaja	29
Gjiganti i hekurt	30
Natën e mirë	31
Mbrëmje dimri	33

Peisazh deti në dimër	34
Lamtumirë shkollë	35
Në fushë	37
Gëzime pune	38
Tungjatjeta xha Murat	39
Bisedë me ndërgjegjen	42
Dritare në aksion	43
Pika e ujit	45
Pak dritë	46
Ushtari në kufi	48
Pranvera troket	49